



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.627/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Auto Sherreti” ShPK me seli në magjistralën Prishtinë-Ferizaj, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.295/22 të datës 06.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Auto Sherreti” ShPK me seli në magjistralen Prishtinë-Ferizaj, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.295/22 të datës 06.03.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Dhoma e Shkallës së Parë me aktgjykimin e ankimuar nën pikën I. të dispozitivit, Refuzohet kërkesëpadia e paditësit “Auto Sherreti” ShPK me seli në magjistralen Prishtinë-Ferizaj, të cilën

sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi nga Prishtina, si e pa bazuar. Nën pikën II. Mbetet në fuqi vendimi nr. 01.3.2.2/8877 i datës 21.07.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë. Nën pikën III. Secila palë bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit Auto Sherreti ShPK me seli në Ferizaj, të prishet aktgjykimi KF.nr.295/22 i datës 06.03.2023 të Gjykatës Komerciale/Dhomat e Shkallës së Parë/ Departamenti Fiskal dhe lënda të kthehet në Gjykatën e Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63.2 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr. 01.3.2.2/8877 të datës 21.07.2021 në pikën I. të dispozitivit të aktvendimit, ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë “Auto Sherreti” ShPK Prishtinë për rishqyrtimin e aktvendimit numër 07.3/112; 113/2014 datë 19.07.2017; 01.3.2.3/6242/13.04.2021 të lëshuar nga Sektori i Përfaqësimeve për lejimin e pagesës në emër të kamatës së grumbulluar si të pa bazuar. Në pikën II. Aktvendimi numër 07.3/112; 113/2014 datë 19.07.2017 01.3.2.3/6242/13.04.2021 i lëshuar nga Sektori i Përfaqësimeve.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal për këtë çështje ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor me datë 06.03.2023 në prani të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur dhe vërtetimit të gjendjes faktike, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e

paditësit duke lënë në fuqi aktvendimin e kontestuar, sipas theksimeve si në arsyetim ndër të tjera se: Gjykata vlerësoi si të pa bazuar pretendimin e paditësit se e paditura ka qenë e obliguar që përvec kthimit të shumës së përgjithshme të detyrimeve doganore të llogarisë edhe kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së këtij kontesti, kjo bazuar në nenin 292, paragrafi (b) pika (i) e KDA-së, kjo për faktin se e paditura Dogana e Kosovës me aktvendimin kontestues nr.07.3/112; 113/2014 të datës 19.07.2017 , 01.3.2.3/6242/13.04.2021 të vërtetuar me aktvendimin nr. 01.3.2.2/8877 të datës 21.07.2021 nuk ka vendosur qoftë si organ i shkallës së dytë mbi bazën e ankesës në procedurë administrative qoftë sipas Aktgjykimit të Gjykatës kompetente në rishqyrtim rivendosi për të drejtën e palës këtu paditësit për kthimin e mjeteve të paguara më tepër në emër të Deklaratave Unike Doganore kontestuese, në mënyrë që të mund të aplikohet edhe kamata nga neni 292, paragrafi (B) pika (i) e KDA-së por vetëm ka ekzekutuar dispozitivin e aktgjykimit A.nr.1469/17 të datës 19.11.2019. Gjykata nga Aktgjykimi A.nr.1469/17 i datës 19.11.2019 ka gjetur se nuk ka vendosje meritore nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal edhe lidhur me kamatën ligjore, ngase nuk ka pasur kërkesë lidhur me këtë, andaj në këtë rast e paditura Dogana e Kosovës duke qenë e lidhur me këtë aktgjykim vetëm e ka zbatuar dispozitivin e aktgjykimit si më lartë. Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur, kjo për faktin se paditësi në këtë kontest tregtar administrativ ka dështuar që të prezantoj provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tij si në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantoj para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij. Gjykata vlerëson se aktvendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Prandaj mbi gjendjen e fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave gjykata konstaton se paditësi në këtë kontest tregtar administrativ nuk ka arritur që të paraqes fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij ngase edhe me nenin 7.1 të LPK-së përcaktohet se “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla” ndërsa në nenin 319.1 të LPK-së përcaktohet se “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i kësaj gjykate, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve ankimore, as me shkelje qenësore të dispozitave të LKA-së, dhe të LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji gjen se Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-aktvendimit të Doganës së Kosovës, të atakuar nga paditësi mbështetur edhe në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të atakuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se e paditura nuk ka vendosur mbi bazën e ankesës në procedurë administrative sipas aktgjykimit të Gjykatës në rigjykim dhe rivendosje për të drejtën e palës këtu paditësit për kthimin e mjeteve të paguara më tepër në emër të deklaratave unike doganore kontestuese, në mënyrë që të mund të aplikohet edhe kamata nga neni 292 paragrafi (b) pika (i) e KDA-së por vetëm ka ekzekutuar dispozitën e Aktgjykimit A.nr.1469/17 të datës 19.11.2019, pasi që nuk ka qenë kërkesë e palës në procedurë gjyqësore dhe se gjykata në procedurën e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit administrativ të kontestuar vepron brenda kufijve të kërkesës kjo sipas nenit 44 par.1 të LKA-së Ligjit 03/L-202. Kolegji njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë, vlerëson se Dogana e Kosovës, bazuar në faktet e cekura si më lartë ka vepruar sipas dispozitivit të aktgjykimit ngase nuk ka pasur kërkesë të palës lidhur me kamatën ligjore.

Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, se aktgjykimi i kontestuar në dispozitivin e tij është kundërthënës me arsyetimin dhe i pakuptueshëm pasi nuk janë analizuar në mënyrë të duhur faktet dhe provat vendimtare, po ashtu nuk është dhënë arsyetim i mjaftueshëm për mos pranimin e pretendimeve të paditësit dhe për faktet vendimtare. Duke pasur parasysh një vendosje të tillë konsiderojmë se gjykata ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së, përkatësisht dispozitën ligjore nga neni 182 par.2 pika n, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar

seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata ka pranuar konstatimet e pavërteta të paditurës për shkak se nuk ka qenë e përfshirë kamata në aktgjykimin A.nr.1469/17 të datës 19.11.2019, mirëpo gjykata nuk ka marrë për bazë faktin se kërkesa për kamatë nuk ka qenë në shqyrtim më herët në gjykatë, pra nuk është kërkuar në mënyrë shprehimore nga paditësi më herët, por një kërkesë e tillë është parashtruar tek e paditura me anë të ankesës së datës 21.05.2021 e cila është refuzuar me anë të aktvendimit të atakuar. Pra kërkesa aksesore nuk është trajtuar më herët as nga e paditura as nga gjykata por lidhur me këtë nuk ka pasur kundërshtim parashkrimi dhe si e tillë e njëjta ka qenë kërkesë e bazuar në ligj. Dhoma e Shkallës së dytë vlerëson se gjendja faktike e çështjes gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur është vërtetuar në mënyrë të plotë. Kolegji po ashtu vlerëson se pretendimet në të cilat thirret në ankesë paditësi, vërtetohet se nga Dhoma e Shkallës së Parë janë shqyrtuar në tërësi, por nuk është arrit të dëshmohet se janë të qëndrueshme dhe bindëse materiale, për tu dëshmuar se kërkesa e paditësit lidhur me kamatën e kërkuar është e bazuar në ligj. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata në këtë çështje ka interpretuar dhe aplikuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore nga neni 292 të KDA-së, prandaj paditësit i është refuzuar kërkesëpadia pa bazë ligjore dhe pa arsyetim të mjaftueshëm për faktet vendimtare. Kolegji vlerëson se dispozita e nenit 292 i KDA-së 03/L-109, parasheh se “Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instancë të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor paragrafi (b) “të apeluesit, Dogana duhet që të”, pika (i) “ të rikthej çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”. Andaj kolegji vlerëson njëjtë si Dhoma e Shkallës së parë kur thekson se kjo dispozitë gjen zbatim në rastet kur çështja zgjidhet përfundimisht me vendim meritore nga vet gjykata, e nëse gjykata kompetente nuk ka vendosur edhe për kamatën, kjo ngase nuk ka qenë kërkesë dhe se gjykata në procedurën e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit administrativ të kontestuar vepron brenda kufijve të kërkesës, kjo sipas nenit 44 par. 1 Të LKA-së Ligjit 03/L-202.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të

paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhoma e Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.627/23, me datë 19.04.2024

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**